

Pasqyrat Financiare

CORAL ALBANIA Sha

31 Dhjetor 2021

Përmbajtja


	Faqe
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	7
DEKLARATA E HARTUESIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	25

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2021
(në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
AKTIVET			
Mjetet monetare dhe ekuivalente	5	5,386,668	9,009,127
Të tjera të drejta të arkëtueshme	6	649,897	426,421
Totali i aktiveve afatshkurtra		6,036,565	9,435,548
Aktive afatgjata jo materiale, neto	7	11,417,996	11,417,996
Totali i aktiveve afatgjata		11,417,996	11,417,996
TOTALI I AKTIVEVE		17,454,561	20,853,544
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Llogari e kërkesa të pagueshme	8	85,756	79,220
Sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore te pagueshme	9	16,740	14,508
Të tjera të pagueshme	10	846,723	792,905
Totali i detyrimeve afatshkurtra		949,219	886,633
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		949,219	886,633
Kapitali i regjistruar		24,727,500	24,727,500
Humbja e akumuluar		-8,222,158	-4,760,859
Totali i kapitalit	13	16,505,342	19,966,911
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		17,454,561	20,853,544

nga:


Ilias Păpadimitriou ;

Administrator


Prodromos Tastsoglou

Administrator



Shih shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Shih shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2021
(në Lek)

Pasqyra e Fitim Humbjes dhe të ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

	Shënime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Të Ardhura			
Shitje shërbime	14	-	-
Të ardhurat totale		<u>-</u>	<u>-</u>
Kostot operative			
Shpenzime për personelin	15	-200,880	-174,096
Zhvlerësim dhe amortizim	7	-	-
Shpenzime administrative dhe të tjera	16	-2,979,037	-2,431,725
Totali i shpenzimeve operative		<u>-3,179,917</u>	<u>-2,605,821</u>
Humbja neto nga operacionet		<u>-3,179,917</u>	<u>-2,605,821</u>
Totali i të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	17	-281,653	159,470
Humbja para tatimit		<u>-3,461,569</u>	<u>-2,446,351</u>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	-	-
Humbja për vitin		<u>-3,461,569</u>	<u>-2,446,351</u>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		<u>-3,461,569</u>	<u>-2,446,351</u>

Shih shenimet shpjeguese që janë pjese perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2021
(në Lek)

Pasqyra e Flukseve Monetare

	Shënime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit			
Fitimi (humbja) para tatim fitimit		<u>-3,461,569</u>	<u>-2,446,351</u>
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit para rregullimeve në kapitalin punues		<u>-3,461,569</u>	<u>-2,446,351</u>
(Rritje) / ulje e llogarive të arkëtueshme dhe të tjera	6	-223,477	-223,636
Rritje / (ulje) në furnitorë dhe të tjera detyrime	8,9,10	<u>62,587</u>	<u>-331,228</u>
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		<u>-3,622,459</u>	<u>-3,001,215</u>
Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		<u>-3,622,459</u>	<u>-3,001,215</u>
Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit			
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë e investimit		<u>-</u>	<u>-</u>
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë financiare		<u>-</u>	<u>-</u>
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente		-3,622,459	-3,001,215
Mjete monetare dhe ekuivalente më 1 Janar	4	9,009,127	12,010,342
Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 Dhjetor	4	<u>5,386,668</u>	<u>9,009,127</u>

Shih shenimet shpjeguese që janë pjese perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2021
(në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i Regjistruar	Humbja e mbartur	Totali
Gjendja më 01 Janar 2020	24,727,500	-2,314,238	22,413,262
Humbje e periudhës	-	-2,446,351	-2,446,351
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	24,727,500	-4,760,589	19,966,911

	Kapitali i Regjistruar	Humbja e mbartur	Totali
Gjendja më 01 Janar 2021	24,727,500	-4,760,589	19,966,911
Humbje e periudhës	-	-3,461,569	-3,461,569
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	24,727,500	-8,222,158	16,505,342

Shënimet e Pasqyrave Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Coral Albania Sha ("Shoqëria") është një shoqëri aksionere, e themeluar dhe krijuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më 14 Nëntor 2018. Selia e shoqërisë është në "Reshit Çollaku", Shk.4, Ap.44, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është regjistruar pranë autoriteteve fiskale me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm (NIPT) L82314029E.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë do të jetë Import-Eksport, shitje me shumice dhe pakicë i karburantit, gazit dhe cdo lloj aktiviteti tjetër në përputhje me ligjin dhe që i shërben operacioneve të mësipërme. Gjatë vitit 2021, shoqëria nuk kishte aktivitet.

Administrator të Shoqërisë janë : Z. Ilias Papadimitriou dhe Z. Prodromos Tastsoglou. Më 31 Dhjetor 2021 shoqëria kishte 2 (dy) punonjës (31 Dhjetor 2020: 2 (dy) punonjës).

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 11 Shkurt 2022.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Politikat kryesore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e pasqyrave financiare, janë në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike. Monedha e raportimit është Leku Shqiptar ("Lek") që është gjithashtu edhe monedha funksionale.

Shoqëria mban librat e saj kontabel dhe publikon pasqyrat e saj statutores financiare në përputhje me Ligjin 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNRF, të cilat u bënë të detyrueshme në Shqipëri në bazë të vendimit të Ministrisë së Financave Nr. 65, dt. 05.05.2008, "Për publikimin dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve ndërkombetare të kontabilitetit dhe standardeve ndërkombetare të raportimit financiar, të perkthyer në gjuhën shqipe".

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare netohen kundrejt njëra tjetres dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjrisht e zbatueshme për të netuar shumën e njohura dhe ka qellim shlyerjen e tyre mbi bazë neto, ose të realizojë aktivitetet dhe të shlyejë detyrimet në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk netohen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, përveç nëse kërkohet ose lejohet nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet e tyre, dhe sic parashikohet në mënyrë specifike në politikat kontabel te shoqërisë.

Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)

2.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2021:

- **Ndryshimet në SNRF 4, SNRF 7, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 39: Reforma e Normës së Interesit**
- **Ndryshimet në SNRF 16: Koncesionet e Qirave të Lidhura me Covid-19;**

Megjithëse këto standarde dhe ndryshime të reja janë aplikuar për herë të parë duke filluar nga 1 Janar 2021, ato nuk kanë patur impakt material, në pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë Natyra dhe ndikimi i cdo standardi dhe ndryshimi është përshkruar si vijon:

- **Ndryshimet në SNRF 4, SNRF 7, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 39: Reforma e normës së interesit**

Më 27 gusht 2020, BSNK publikoi Reformën e Standardit të Normës së Interesit — Faza 2 (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16) me ndryshime që trajtojnë çështje që mund të ndikojnë në raportimin financiar pas reformës së një norme interesi standard, duke përfshirë zëvendësimin e tij me norma standarde alternative.

Ndryshimet në Reformën standarde të normës së interesit — Faza 2 (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16) lidhen me modifikimin e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe detyrimeve të qirasë, kërkesat specifike të kontabilitetit dhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese duke zbatuar SNRF 7 për të shoqëruar ndryshimet në lidhje me modifikimet dhe kontabilitetin.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2021. Këto ndryshime nuk kanë pasur ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- **Ndryshimet në SNRF 16 Lidhur me lehtësira e lidhura me qeranë si pasojë e Covid 19**

Më 31 mars 2021, BSNK lëshoi Koncesionet e Qirasë të Lidhura me Covid-19 përtej datës 30 Qershor 2021- amendament i SNRF 16 Qiratë, që zgjat, me një vit, amendamentin e majit 2020 që u jep qiramarrësve një përjashtim nga vlerësimi nëse një COVID-19 -Koncesioni i lidhur me qiranë është një modifikim i qirasë.

Si një mjet praktik, një qiramarrës mund të zgjedhë të mos ndryshojë nëse një lehtësim qiraje në lidhje me Covid-19 nga një qiradhënës është një modifikim i qirasë. Një qiramarrës që i bën këto zgjedhje llogarit për çdo ndryshim në pagesat e qirasë që rezultojnë nga lehtësimi i qirasë në lidhje me Covid-19 në të njëjtën mënyrë që do të llogariste ndryshimin sipas SNRF 16, nëse ndryshimi nuk do të ishte një modifikim i qirasë. Paragrafi CIC parashikon një qiramarrës do të zbatojë ndryshimin në SNRF 16 për periudhat të raportimit që fillojnë më ose pas 1 prill 2021. Lejohet aplikimi më i hershëm. Ky ndryshim nuk kishte asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

2.2 Standarde dhe interpretime të reja që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe ende nuk janë zbatuar përpara datës efektive

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi, deri në datën e deklarimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, janë pasqyruar më poshtë. Shoqëria synon të adoptojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, kur ato të bëhen efektive.

- SNRF 17: Kontratat e sigurimit;

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (SNRF17), një standard i ri kontabël gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve që mbulon njohjen dhe matjen, prezantimin dhe shënimet shpjeguese. Pasi të bëhet efektiv, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) që është nxjerrë në vitin 2005. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth., jetë, jo-jetë, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi), pavarësisht nga lloji i subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionare. Do të ketë disa përjashtime nga objektivi. Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model kontabiliteti për kontratat e sigurimit që të jetë më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguruesit. Në kontrast me kërkesat e SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme të kontabilitetit, SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. SNRF 17 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2021 dhe zbatimi i tij kërkon paraqitjen e vlerave krahasuese të periudhave të mëparshme. Aplikimi i më hershëm është i lejueshëm me kusht që Shoqëria të aplikojë SNRF 9 dhe SNRF 15 më ose përpara datës së aplikimit të SNRF 17. Ky standard nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.

- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose kontributi i Aktiveve nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët

Ndryshimet adresojnë konfliktin midis SNRF 10 dhe SNK 28 për trajtimin e humbjes së kontrollit mbi një filial që shitet ose kontribuohet tek një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët. Ndryshimet sqarojnë se fitimi ose humbja që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që përbëjnë një biznes, siç përcaktohet në SNRF 3, nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët, njihet plotësisht. Çdo fitim ose humbje që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që nuk përbëjnë një biznes, njihet vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët. BSNK ka shtyrë datën efektive të këtyre ndryshimeve për një kohë të pacaktuar, por një njësi ekonomike që i aplikon ndryshimet me heret duhet t'i zbatojë ato në mënyrë prospektive. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- Ndryshimet në SNK 1: Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtra ose Afatgjata

Në janar 2020, BSNK lëshoi ndryshime në paragrafët 69 deri 76 të SNK 1 për të specifikuar kërkesat për klasifikimin e detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata. Ndryshimet sqarojnë:

- Çfarë nënkuptohet me të drejtën për të shtyrë zgjidhjen detyrimit
- Se e drejta për shtyrje duhet të ekzistojë në fund të periudhës së raportimit
- Klasifikimi nuk preket nga gjasat që një njësi ekonomike të ushtrojë të drejtën e saj të shtyrjes
- Kjo vetëm nëse një instrument derivativ i konvertueshëm në detyrim është vetë një instrument i kapitali, kushtet e një detyrimi nuk do të ndikojnë në klasifikimin e tij

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

2.2 Standarde dhe interpretime të reja që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe ende nuk janë zbatuar përpara datës efektive (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 8: Vlerësimet kontabël

Më 12 shkurt 2021, BSNK publikoi Përkufizimin e Vlerësimeve Kontabël (Ndryshime në SNK 8) për të ndihmuar njësitë ekonomike të bëjnë dallimin midis politikave kontabël dhe vlerësimeve kontabël.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 janarit 2023 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- Ndryshimet në SNK 12: Tatimi i shtyrë;

Më 7 maj 2021, BSNK publikoi tatimin e shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12) që sqarojnë se si kompanitë llogarisin tatimin e shtyrë për transaksione të tilla si qiratë dhe detyrimet e nxjerrjes nga përdorimi.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 janarit 2023 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- Ndryshime të SNRF 3 Referencë e Kornizës Konceptuale

Në Maj të vitit 2020, BSNK publikoi ndryshime në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - Referencë në Kuadrin Konceptual. Ndryshimet kanë për qëllim të zëvendësojnë referencën në Kornizën për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare, të lëshuar në 1989, me një referencë në Kornizën Konceptuale për Raportimin Financiar të lëshuar në Mars 2018 pa ndryshuar ndjeshëm kërkesat e saj. Bordi gjithashtu shtoi një përjashtim në parimin e njohjes së SNRF 3 për të shmangur çështjen e fitimeve ose humbjeve të mundshme të 'ditës 2' që lindin për pasivet dhe pasivet e kushtëzuara që do të ishin brenda fushës së SNK 37 ose KIRFN 21 Detyrime, nëse ndodhin veçmas. Në të njëjtën kohë, Bordi vendosi të sqarojë udhëzimet ekzistuese në SNRF 3 për aktivet e kushtëzuara që nuk do të ndikohen duke zëvendësuar referencën në Kuadrin për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2022 dhe zbatohen në mënyrë prospektive.

- Ndryshime të SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale: Arkëtime përpara përdorimit të synuar

Në Maj të vitit 2020, BSNK publikoi Aktivet Afatgjata Materiale – Arkëtime para përdorimit të synuar, i cili ndalon njësitë ekonomike të zbresin nga kostoja e një e aktiveve afatgjata materiale, çdo të ardhur nga shitja e produkteve të prodhuara ndërsa e sjellin atë aktiv në vendin dhe gjendjen e nevojshme që asetit të jetë i aftë të veprojë në mënyrë të parashikuar nga Drejtimi. Në vend të kësaj, një njësi ekonomike i njeh të ardhurat nga shitja e produkteve të tillë dhe kostot e prodhimit të këtyre produkteve, në fitim ose humbje. Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2022 dhe duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive për produktet e aktiveve afatgjata materiale të vendosura në dispozicion për përdorim në ose pas fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur kur njësi ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin. Ndryshimet nuk pritet të kenë një ndikim material për Shoqërinë.

2.2 Standarde dhe interpretime të reja që nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe ende nuk janë zbatuar përpara datës efektive (vazhdim)

- Ndryshime të SNK 37 Kontrata të vështira – Kostoja për përmbushjen e kontratës

Në Maj të vitit 2020, BSNK publikoi ndryshime në SNK 37 për të specifikuar se cilat kosto duhet të përfshijë një njësi ekonomike kur vlerëson nëse një kontratë është e vështirë ose që shkakton humbje. Ndryshimet zbatohen një “qasje të lidhur drejtpërdrejt me kostot”. Kostot që lidhen drejtpërdrejt me një kontratë për të siguruar mallra ose shërbime përfshijnë si kostot ritëse ashtu edhe një alokim të kostove që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e kontratës. Kostot e përgjithshme dhe administrative nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me një kontratë dhe përjashtohen nëse nuk i ngarkohen palës tjetër në mënyrë të qartë sipas kontratës. Ndryshimet janë efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2022. Shoqëria do t'i zbatojë këto ndryshime në kontratat për të cilat ende nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj në fillim të periudhës raportuese vjetore në të cilën aplikon për herë të parë ndryshimet.

- Përmirësime Vjetore 2018-2020

SNRF 1 Adoptimi Fillestar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar – Filiali si aplikues për herë të parë

Ndryshimi lejon një filial që zgjedh të zbatojë paragrafin D16 (a) të SNRF 1 për të matur ndryshimet kumulative të përkthimit duke përdorur shumat e raportuara nga shoqëria mëmë, bazuar në datën e tranzicionit të shoqërisë mëmë në SNRF. Ky ndryshim zbatohet gjithashtu për një ndërmarrje të lidhur ose të përbashkët që zgjedh të zbatojë paragrafin D16 (a) të SNRF 1. Ndryshimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2022, duke lejuar aplikimin e më hershëm. Ndryshimet nuk kanë ndikim tek Shoqëria.

SNRF 9 Instrumentet Financiar – Tarifa në “10 përqind” test për ç'njohjen e detyrimeve financiare

Ndryshimi sqaron tarifën që një njësi ekonomike përfshin kur vlerëson nëse kushtet e një detyrimi të ri financiar ose të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme nga kushtet e detyrimit origjinal financiar. Këto tarifa përfshijnë vetëm ato të paguara ose të marra ndërmjet huamarrësit dhe huadhënësit, përfshirë tarifën e paguara ose të marra nga huamarrësi ose huadhënësi. Një njësi ekonomike zbaton ndryshimin në detyrimet financiare që modifikohen ose shkëmbehen në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësi ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin. Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022, duke lejuar aplikimin e më hershëm. Shoqëria do të zbatojë ndryshimet në detyrimet financiare që modifikohen ose shkëmbehen në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësi ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin. Ndryshimet nuk priten të kenë një ndikim material për Shoqërinë.

SNK 41 Bujqësia – Taksimi në matjen e vlerës së drejtë

Ndryshimi heq kërkesën në paragrafin 22 të SNK 41 që njësitë ekonomike përjashtojnë flukset e parave për tatimin kur matni vlerën e drejtë të aktiveve brenda objektit të SNK 41. Një njësi ekonomike zbaton ndryshimin në mënyrë prospective për matjet e vlerës së drejtë në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2022, duke lejuar aplikimin e më hershëm. Ndryshimet nuk priten të kenë një ndikim material tek Shoqëria.

Shoqëria ka zgjedhur të mos i implementojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar.

Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)

3. Vleresimet e rendesishme kontabel dhe supozimet.

Në aplikimin e politikave kontabel të shoqërisë, që përshkruhen në Shënimin nr 2, nga drejtimi kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime për vlerën kontabel të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuar në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen rrelevant. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet tek vlerësimet kontabel do të njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar nëq rishikimi afekton vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudha të ardhshme nëq rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe të ardhme.

Pasiguria në gjykime

Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen në vlerën në të cilën vlera kontabel e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të parase tejkalojnë vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga cdo njësi gjeneruese të parase dhe përcakton një normë interesi të pershtatshme kur kalkulohet vlera aktuale e këtyre flukseve parash.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi i Shoqërisë në mënyrë të rregullt analizon jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në datën e pasqyrave financiare. Drejtimi vlerëson që jeta e dobishme të përcaktuar për aktivet paraqet dobishmerinë e pritshme të aktiveve. Vlera kontabel e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin 7. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve teknologjike.

4. Permbledhje e politikave të rendesishme kontabile

4.1 Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhe të huaja janë të konvertuara në leke dhe regjistrohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet monetare dhe zera të tjera jo monetare në monedhe të huaja rivelesohen në leke me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e fundit të periudhës raportuese. Diferencat e këmbimit valutator janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirë të Shoqërisë. Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për përkthimin e zerave të pozicionit financiar të shprehur në monedhe të huaja paraqiten si vijon (në Leke):

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
1 EUR	120.76	123.70
1 USD	106.54	100.84

4.2 Aktivët afatgjatë materiale dhe jo-materiale

Aktivët afatgjatë material dhe jo-materiale janë deklaruar me vlerën kontabel neto, pas zbritjes së amortizimit të akumuluar dhe/ose humbjeve të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuar janë si më poshtë:

	Normat e zhvlerësimit % 2021	Normat e zhvlerësimit % 2020	Bazë e llogaritjes
Aktivët afatgjatë jo materiale			
Softëares	25	25	Vlera kontabel neto
Te tjera aktive jo-materiale	15	15	Vlera bruto

Vlera kontabel e aktiveve afatgjatë jo-materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabel mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëq. rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabel tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivet ose njësitë

Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)

gjeneruese të parasë do të pakësohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3 Aktivët dhe detyrimet financiare

Shoqëria fillimisht njihet llogarite e arketueshme dhe depozitat monetare në datën kur ato janë krijuar. Aktivët Financiare klasifikohen në njohjen fillestar dhe maten me vone me kosto të amortizueshme, me vlerë të drejtë nepermjet të ardhurat gjithëpërfshirëse (OCI), dhe me vlerë të drejtë nepermjet fitimit ose humbjes. Të gjitha aktivët e tjera financiare (duke përfshirë aktivët e percaktuara me vlerë të drejtë nepermjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e tregimit në të cilën Shoqëria behet pale në kushtet kontraktuale të instrumentit. Shoqëria c'registron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse nga aktiviteti financiar në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësive së aktiviteti financiar janë transferuar. Çdo interes në aktivët financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria është njohur si një aktiv apo detyrim i vecantë. Aktivët dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Shoqëria ka të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe synon ose të shlyejë mbi një bazë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përfshijnë llogarite e kërkesa të arketueshme dhe të tjera të arketueshme, mjetet monetare, dhe furnoret dhe detyrime të tjera.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë parate e mbajtura në bankat lokale në monedhen vendase dhe të huaja dhe paraqiten me kosto.

Furnoret dhe detyrime të tjera

Furnoret dhe detyrime të tjera janë pasqyruar fillimisht me vlerë të drejtë dhe me pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.4 Zhvleresimet

Aktivët financiarë

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë nepermjet fitimit ose humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të percaktuar nëse ka një evidence objektive se ai është zhvlerësuar. Shoqëria njihet një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë (ECL) për të gjitha instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerë të drejtë nepermjet fitimit ose humbjes. ECL bazohen në diferencën ndërmjet flukseve monetare kontraktuale që duhet të paguhet në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukse monetare që Shoqëria pret të marrë, të skontuara me një përafrim të normës fillestare të interesit efektiv. Flukset monetare priten të përfshijnë flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose të ardhura të tjera që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale. Humbja nga zhvlerësimi i një aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferenca midis vlerës kontabel dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të vlerësuar të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe pasqyrohen në një llogari zhvlerësimi perkundrejt llogarive të arketueshme. Interesat mbi aktivët e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nepermjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pasuese ndikon në uljen e shumës së zhvlerësimit, renia në humbjen nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Për të llogaritur e arkëtueshmet tregtare, Shoqëria zbaton një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e ECLs. Si rrjedhojë, Shoqëria nuk ndjek ndryshimet në rrezikun e kredisë, por në vend të kësaj njihet një humbje nga zhvlerësimi të bazuar në jetgjatësinë e ECL-ve në çdo datë raportimi. Shoqëria ka krijuar një matricë provizionesh që bazohet në përvojën e saj historike të humbjeve nga kreditimi, të përshtatur për faktorët e ardhshëm që janë specifikë për debitorët dhe mjedisin ekonomik.

Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)

Aktivet jo-financiare

Vlerat kontabel e aktiveve jo-financiare te Shoqerise rishikohet ne daten e raportimit per te percaktuar nese ka evidenca per zhvleresim. Nese ka evidenca te tilla, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme eshte me e madhja midis vleres se drejte minus kostot per shitje dhe vleres ne perdorim. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset e ardhshme te mjeteve monetare jane skontuar ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave qe reflekton vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziqet specifike per aktivitetin per te cilat vleresimet e flukseve monetare te ardhshme nuk jane rregulluar. Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabel e nje aktiviteti ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare tejkalon vleren e rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjithepershires (ne fitim ose humbje).

4.5 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat perfshijne te ardhurat nga shitja e mallrave dhe kryerja e sherbimeve.

Te ardhurat maten duke ju referuar vleres se drejte te shumes se marre ose te arketueshme nga Shoqeria per mallrat e shitura dhe te sherbimeve te ofruara, duke perjashtuar taksat e shitjeve, rimbursimet, dhe skontot tregtare.

Shoqeria zbaton kriteret e njohjes se te ardhurave te percaktuara me poshte per secilin komponent te identifikueshem te transaksionit te shitjes per te reflektuar thelbin e transaksionit. Shuma e marre nga keto transaksione eshte ndare ne komponentin e vecante te identifikueshem duke marre parasysh vleren relative te drejtepercdo komponent.

Te ardhurat njihen kur shumata e te ardhurave mund te matet ne menyre te besueshme, mbledhja eshte e mundshme, shpenzimet e bera ose qe do te behen te mund te maten me besueshmeri, dhe kur kriteret per secilin nga aktivitetet e ndryshme te Shoqerise jane permbushur. Keto kriteret njohje sipas aktiviteteve specifike jane te bazuara ne mallrat apo zgjidhjet e ofruara per konsumatorin dhe kushtet e kontrates ne cdo rast, dhe jane pershkruar me poshte:

Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat e interesit mbi fondet e investuara ne depozita bankare dhe fitimet ne valute te huaj.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit mbi huamarrjet, humbjet ne valute te huaj, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes, dhe humbjet e njohura nga zhvleresimi i aktiveve financiare.

Fitimet dhe humbjet nga kembimi valutor raportohen ne baza neto.

4.6 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin llogaritet ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar mbi Tatimin mbi Fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje per sa kohe qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera gjithepershires.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose substancialisht ne fuqi ne daten e raportimit, dhe cdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre eshte njohur duke perdorur metoden e bilancit kontabel, nga diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe shumave te perdorura per qellime tatimi. Tatimi i shtyre eshte matur ne norma te tatimit qe pritet te aplikohen ndaj diferencave te perkohshme kur ato te ndryshojne, bazuar ne ligjet qe jane miratuar ose priten te miratohen ne daten e raportimit.

Pasqyrat Financiare
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per sa kohe eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem te jete ne dispozicion kundrejt te cilit mund te perdoret ndryshim i perkohshem. Aktivet e tatimit te shtyre (nese ka) jane rishikuar ne secilen date te raportimit dhe jane reduktuar deri ne masen ku nuk eshte e mundur qe perfitimet nga tatimi do te realizohen.

4.7 Perfitimet pas-daljes ne pension dhe planet e pensioneve

Shoqeria kryen vetem kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore qe ofrojne punonjesve perfitime pas daljes ne pension. Qeveria e Shqiperise eshte pergjegjese per percaktimin e limitit minimal ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e shoqerise ndaj planit te pensioneve jane ngarkuar ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

4.8 Kapitali

Kapitali aksioner perbehet prej mjeteve monetare te kontribuar nga themeluesit e shoqerise. Kapitali aksioner mbahet ne shumen e konvertuar leke te monedhes se huaj te marre, duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

4.9 Provigjonet

Nje provigjon njihet kur Shoqeria ka nje detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve te meparshme dhe eshte e mundur qe te kete nje dalje te burimeve qe perfaqesojne perfitimet ekonomike per te shlyer detyrimin, dhe mund te behet nje vleresim i besueshem i shumes se detyrimit. Provigjonet rishikohen ne cdo date te pozicionit financiar dhe rregullohen per te reflektuar vleresimin me te mire aktual. Kur efekti i vleres ne kohe te parase eshte material, shuma e provigjonit eshte vlera aktuale e shpenzimeve te pritshme te nevojshme per shlyerjen e detyrimit. Provigjonet nuk njihen per humbjet e ardhshme operative.

4.10 Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen ne shenimet shpjeguese pervec rasteve kur mundesia e nje dalje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte shume e ulet. Nje aktiv i kushtezuar nuk njihet ne pasqyrat financiare por eshte pasqyruar ne shenimet shpjeguese kur hyrja e perfitimeve ekonomike eshte e mundshme. Shuma e humbjes se kushtezuar eshte njohur si provigjon nese eshte e mundshme qe ngjarjet e ardhshme do te konfirmohen dhe se mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes se humbjes ne daten e pozicionit financiar.

4.11 Transaksionet e paleve te lidhura

Palet e lidhura jane ato ku njera nga palet eshte e kontrolluar nga tjetra, ose ka ndikim te rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare apo të biznesit të palet tjetër.

4.12 Ngjarje pas periudhes se raportimit

Ngjarjet pas perfundimit te vitit te cilat japin informacione shtese per poziten e shoqerise ne daten e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas perfundimit te vitit qe nuk jane ngjarje rregulluese jane pasqyruar ne shenime kur jane materiale.

Pasqyrat Financiare
Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2021
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

5 Mjetet monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare dhe ekuivalente janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
<u>Llogari rriedhëse ne banka</u>		
- në monedhe vendase	984,507	1,964,808
- në monedhë të huaj	4,402,161	7,044,319
Totali	5,386,668	9,009,127

6 Të tjera të drejta të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
TVSH e arkëtueshme	643,897	426,421
Parapagim për programin e fiskalizimit	6,000	-
Totali	649,897	202,785

7 Aktivët afatgjatë jomateriale

	Pajisje Informatike	Totali
Kosto		
Më 1 Janar 2021	11,417,996	11,417,996
Shtesa	-	-
Më 31 Dhjetor 2021	11,417,996	11,417,996
Amortizimi		
Më 1 Januar 2021	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Më 31 Dhjetor 2021	-	-
Vlera Neto Kontabël më 01 Janar 2021	11,417,996	11,417,996
Vlera Neto Kontabël më 31 Dhjetor 2021	11,417,996	11,417,996
	Pajisje Informatike	Total
Kosto		
Më 1 Janar 2020	11,417,996	11,417,996
Shtesa	-	-
Më 31 Dhjetor 2020	11,417,996	11,417,996
Amortizimi		
Më 1 Januar 2020	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Më 31 Dhjetor 2020	-	-
Vlera Neto Kontabël më 01 Janar 2020	11,417,996	11,417,996
Vlera Neto Kontabël më 31 Dhjetor 2020	11,417,996	11,417,996

Aktivët afatgjatë jomateriale nuk janë amortizuar pasi nuk janë ende gati për përdorim.

Pasqyrat Financiare
Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2021
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

8 Furnitorë

Furnitorët përfshijnë detyrimet kundrejt furnitorëve të huaj dhe vendas. Balancat e furnitorëve janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Furnitore vendas	85,756	79,220
Furnitore të huaj	-	-
Totali	85,756	79,220

Furnitorët nuk mbartin interes.

9 Sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të pagueshme

Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore të pagueshme, i përkasin muajit dhjetor 2021.

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Sigurime shoqërore e shëndetsore	16,740	14,508
Totali	16,740	14,508

Sigurimet shoqërore e shëndetsore shlyhen jo më vonë se 20 ditë pas mbylljes së tremujorit.
Numri mesatar i punonjësve është 2 (dy).

10 Të tjera të pagueshme

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2021
Shpenzime të llogaritura	287,452	268,335
Detyrime për taksat lokale	554,221	524,570
Detyrime për TPA Albania Shpk (<i>rimbursim</i>)	5,050	-
Totali	846,723	792,905

11 Provigjone

Shoqëria nuk kishte provigjone apo detyrime të kushtezuara për të shpалosur apo regjistruar në pasqyrat financiare në fund të vitit.

12 Detyrime afatgjata

Shoqëria nuk kishte detyrime afatgjata për të regjistruar në pasqyrat financiare në fund të vitit.

13 Kapitali dhe rezervat

Kapitali

Më 31 Dhjetor 2021, sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) totali i kapitalit të regjistruar është 24,727,500 Lekë.

Më poshtë është struktura e kapitalit:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020	%
Medsympan Limited LTD	24,727,500	24,727,500	100%
Totali	24,727,500	24,727,500	100%

Pasqyrat Financiare
Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2021
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

14 Shitje e shërbimeve

Shoqëria gjatë vitit 2021 nuk kishte aktivitet, të ardhurat nga shitja e të mirave dhe shërbimeve për vitin e mbyllur 2021 janë zero.

15 Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	200,880	174,096
Totali	200,880	174,096

16 Shpenzime administrative dhe të tjera

Shpenzimet administrative dhe të tjera operative përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Tarifa honorare	1,190,371	1,284,946
Shërbime kontabiliteti dhe taksash	833,058	782,897
Shërbim konsulence	664,794	62,170
Shërbim perkthimi dhe noteri	253,825	278,912
Taksa vendore	22,800	22,800
Shpenzime për Çertifikatë elektronike dhe nënshkrim elektronik	8,800	-
Shërbim poste	5,050	-
Penalitete	338	-
Totali	2,979,037	2,431,725

17 Të ardhurat (shpenzimet) financiare, neto

Të ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara apo të porealizuara nga kurset e këmbimit si vijon:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Fitim nga kurset e këmbimit	40,717	761,652
(Humbje) nga kurset e këmbimit	-273,470	-565,975
Fitim/(Humbje) neto nga kurset e këmbimit	-232,753	195,677
Të tjera të ardhura financiare	-	-
Të tjera shpenzime financiare (komisione bankare)	-48,899	-36,207
Të tjera të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	-48,899	-36,207
Totali të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	-281,653	159,470

Pasqyrat Financiare
Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2021
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

18 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit për vitin 2021 i llogaritur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
1 Fitimi para tatimit	-3,461,569	-2,446,351
2 Shpenzime të pazbritshme	5,050	-
3 Penalitete, gjoba	338	-
4 Provigjone të panjohura për qëllime tatimore	19,117	-861,955
5 Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3)	-3,437,064	-3,308,307
6 Humbje të mbartura (-)	-4,487,060	-1,178,753
7 Fitim (humbje) e tatueshme	-7,924,124	-4,487,060
8 Norma e tatimit mbi fitimin	0%	0%
9 Shpenzim tatim fitimi	-	-
10 Tatim fitimi i parapaguar	-	-
11 Tatim fitimi i arketueshem (i pagueshëm)	-	-

19 Manaxhimi i Riskut Financiar

19.1 Faktoret e riskut financiar

Aktivitetet e Shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj rreziqeve financiare, duke përfshirë riskun e kredisë dhe risqet që lidhen me efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të Shoqërisë fokusohet në paparashikueshmëri dhe tregjeve dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi ecurinë e biznesit të shoqërisë.

Menaxhimi i riskut kryhet nga Drejtimi bazuar në politikën dhe procedurat që mbulojnë menaxhimin e riskut të përgjithshëm, si dhe tipe të vecanta, të tilla si risku nga kursi i këmbimit, risku i normës së interesit, risku i kredisë, përdorimi i letrave me vlerë të pershtatshme dhe investimi i likuiditetit të tepert.

19.2 Risku i tregut

Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit që vjen nga këmbimet në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro dhe USD. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për të mbrojtur nga risku i këmbimit valutës. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur një gjendje të duhur neto në cdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e perdritshme.

Aktivitetet dhe detyrimet e Shoqërisë në valute të huaja më 31 dhjetor 2020, janë si më poshtë:

Aktivitetet financiare	2021 ALL	2020 ALL
USD	-	-
EUR	4,402,161	7,044,319
	4,402,161	7,044,319
Financial Liabilities		
USD	-	-
EUR	85,756	79,220
	85,756	79,220

Analiza e ndjeshmerisë ndaj kursit të këmbimit

	Ekspozimi neto	10%	2021 -10%
USD	-	-	-
Fitim (humbje) nga këmbimi valutës	-	-	-
EUR	-85,756	-8,576	-8,576
Fitim (humbje) nga këmbimi valutës	-85,756	-8,576	-8,576

Pasqyrat Financiare
Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2021
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

	Ekspozimi neto	10%	2020 -10%
USD	-	-	-
Fitim (humbje) nga kembimi valutor	-	-	-
EUR	-79,220	-7,922	-7,922
Fitim (humbje) nga kembimi valutor		-7,922	-7,922

Analiza e ndjeshmerise perfshin vetem artikujt monetare te shprehura ne monedhe te huaj ne fund te vitit, dhe gjithashtu eshte bere nje korrigjim i vleres se tyre per nje ndryshim 10% ne normat ne valute te huaj. Shuma positive/negative tregon rritjen/renie ne fitim ose kapital, e cila ndodh kur LEK dobesohet/forcohet kundrejt monedhave te huaja me +/- 10%.

Risku i normes se interesit

Rreziku i normes se interesit eshte rreziku qe vlera e drejte ose flukset monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te luhaten per shkak te ndryshimeve ne normat e interesit te tregut. Ekspozimi i Shoqerise ndaj rrezikut te ndryshimeve ne normat e interesit te tregut ka te beje kryesisht me detyrimet afatgjata te qirase financiare te Shoqerise me norma interesi te ndryshueshme. Nuk ka perqendrim te fondesh te marra hua me interes te ndryshueshem nga institucionet financiare ose subjektet te tjera ne daten e raportimit. Ne te njejten kohe, shoqeria nuk ka vendosje te materiale te aseteteve te saj ne depozita me afat dhe letrave me vlerë likuide, qe kane te ardhura shtese te interesit.

	2021	2020
Aktive financiare		
<i>Qe nuk mbartin interes:</i>	-	-
Llogari te arketueshme	-	-
Llogari te arketueshme dhe te tjera	-	-
Total (1)	-	-
<i>Qe mbartin interes fikse:</i>		
Paraja dhe ekuivalentet e saj	5,386,668	9,009,127
Total (2)	5,386,668	9,009,127
Total (1)+(2)	5,386,668	9,009,127
Detyrime financiare		
<i>Qe nuk mbartin interes:</i>		
Llogari te pagueshme	85,756	79,220
Detyrime te tjera	16,740	14,508
	102,496	93,728
<i>Qe mbartin interes variabel:</i>		
Detyrime per hua	-	-
	-	-
	102,496	93,728

19.3 Risku i kreditit

Shoqeria nuk ka risk te rendesishme te kreditit. Shoqeria ka politika per te siguruar qe shitjet e produkteve te behen per klientet me nje historik krediti te pershtatshem. Shoqeria ka politika qe kufizojne sasine e ekspozimit riskut te kreditit per cilindo klient. Risqet e njohura rregjistrohen si provigjone mbi llogarite e arketueshme.

Gjithashtu, risku i kreditit qe vjen nga aktivet e tjera financiare te Shoqerise, te cilat perfshijne mjetet monetare dhe huamarrjen e arketueshme afatshkurter, lind nga vonesa ne pagesa te pales tjetere, me nje ekspozim maksimal te barabarte me vleren kontabel i ketyre instrumenteve

	2021	2020
Vlerat e klasave te aktiveve financiare:		
Mjetet monetare	5,386,668	9,009,127
Llogari dhe kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	-	-
Totali	5,386,668	9,009,127

Pasqyrat Financiare
Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2021
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

19.4 Risku i likuiditetit

Shoqeria menaxhon nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e planifikuara për detyrimet afatgjata financiare si dhe të parashikojë flukset monetare gjatë aktivitetëve të përditshme. Nevojat për likuiditet janë të monitoruara në grupe të ndryshme kohore. Kërkesa neto për mjete monetare është krahasuar me provigjonet për huamarrje në dispozicion në mënyrë që të përcaktohet ndonjë mungesë. Kjo analizë tregon nëse provigjonet e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në fjalë. Shoqeria mban mjete monetare për të përmbushur kërkesat e likuiditetit për periudha minimum 30-ditore. Financimi për nevojat e likuiditetit afat-gjateshte siguroar gjithashtu nga një sasi e mjaftueshme të provigjoneve të kreditit të ndermarra.

Me 31 dhjetor 2021, detyrimet e shoqërisë kanë maturime kontraktuale (duke përfshirë pagesat e interesit aty ku është e aplikueshme), të përmbledhura si më poshtë:

Me 31 dhjetor 2021	Afatshkurter	1 deri 5 vjet	Afatgjate
	1 deri 12 muaj		Me shume se 5 vjet
Llogari e kërkesa të pagueshme	85,756	-	-
Sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të pagueshme	16,740	-	-
Detyrime të tjera	846,723	-	-
	949,219	-	-
<hr/>			
Me 31 dhjetor 2020	Afatshkurter	1 deri 5 vjet	Afatgjate
	1 deri 12 muaj		Me shume se 5 vjet
Llogari e kërkesa të pagueshme	79,220	-	-
Sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të pagueshme	14,508	-	-
Detyrime të tjera	792,905	-	-
	886,633	-	-

Vlerat më sipër janë të barabarta me detyrimet kontraktuale të paskontuara të cilat mund të jenë të ndryshme nga vlera kontabel e detyrimeve në datën e raportimit.

19.5 Menaxhimi i riskut të kapitalit

Objektivat kryesorë të Shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë ruajtja e aftësisë së Shoqërisë për të ofruar në mënyrë të vazhdueshme të ardhura për aksionerët dhe përfitime për investitorët e tjerë dhe të ruajë një strukturë kapitali optimale për të reduktuar kostot e kapitalit.

Në mënyrë që të ruhet dhe rregullohet struktura e kapitalit, Shoqëria mund të rregullojë shumën e dividendëve të paguar aksionerëve, kthejë kapital aksionerëve, emetojë aksione të reja ose të shesë aktive për të reduktuar borxhin.

Gearing ratio (Raporti Borxh/Kapital)

Struktura e kapitalit të Shoqërisë, përfshin detyrimet, mjetet monetare dhe kapitalin, i cili përfshin kapitalin aksioner dhe fitimin e pashpërndarë ose humbjet e akumuluar. Drejtimi rishikon strukturën e kapitalit në baze vjetore si një lidhje midis detyrimeve neto të kredive dhe kapitalit total. Detyrimet neto të kredive llogariten si një diferencë midis detyrimeve totale për huamarrje me vlerën e mjeteve monetare.

Treguesi i borxhit në fund të vitit është si më poshtë:

	2021	2020
Huamarrje me interes	-	-
Llogari e kërkesa të pagueshme dhe detyrime të tjera	949,219	886,633
Mjete monetare	-5,386,668	-9,009,127
Detyrime neto	-4,437,448	-8,122,494
Kapitali	16,505,342	19,966,911
Gearing ratio (Raporti Borxh/Kapital)	-0.27	-0.41

Pasqyrat Financiare
Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2021
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

20 Vlerësimi me vlerë të drejtë

Vlera e drejte perfaqeson vleren me te cilen nje aktiv mund te zevendesohet ose nje detyrim te shlyhet ne kushte te tregut. Vlera e drejte eshte bazuar ne supozimin e drejtimit ne perputhje me profilin e aktivitetit dhe bazen e detyrimit.

20.1 Instrumentat financiarë të cilat janë prezantuar me vlerë të drejtë

Aktivitetet financiare te matura me vlerë te drejte jane ne perputhje me hierarkine e vleres se drejte e cila i grupon aktivitetet dhe detyrimet financiare ne tre nivele bazuar ne rendesine e te dhenave te perdorura gjate matjes se vleres se drejte te aktiveve financiare. Hierarkia e vleres se drejte eshte si vijon:

- **Niveli 1:** cmimet e kuotuar (te pakorigjuara) ne tregjet aktive per aktive ose detyrime financiare te ngjashme;
- **Niveli 2:** te dhena te tjera pervec cmimeve te kuotuar te perfshira ne Nivelin 1 qe jane te disponueshme per aktivitetet dhe detyrimet te observuar, direkt (psh cmimet) ose indirekt (te dhena nga cmimet) dhe
- **Niveli 3:** te dhena mbi aktivitetet dhe detyrimet qe nuk jane te bazuar ne te dhena te disponueshme nga observimi i tregut

Me 31 dhjetor 2021, vlera e aktiveve dhe detyrimeve financiare te Shoqerise ne perputhje me klasifikimin e tyre eshte percaktuar duke perdorur koston e amortizuar.

20.2 Instrumentat financiarë të cilat nuk janë prezantuar me vlerë të drejtë

Me poshte, nje krahasim, sipas klasave, i vlerave te mbartura dhe vlerave te drejta te instrumentave financiare te Shoqerise sic jane pasqyruar ne pasqyrat financiare.

	Vlera e mbartur		Vlera e drejte	
	2021	2020	2021	2020
Aktivitet				
Mjete monetare	5,386,668	9,009,127	9,009,127	9,009,127
Llogari dhe kerkesa te arketueshme	-	-	-	-
Totali i aktiveve	5,386,668	9,009,127	9,009,127	9,009,127
Detyrimet				
Llogari e kerkesa te pagueshme	85,756	79,220	85,756	79,220
Detyrime te tjera	863,463	807,417	863,463	807,417
Totali i detyrimeve	949,219	886,633	949,219	886,633

Mjetet monetare

Vlera e drejte e aktiveve monetare qe perfshijne mjetet monetare, konsiderohet si e perafert me vleren e tyre te mbartur si rezultat i maturimit te tyre me te vogel se 3 muaj.

Furnitore dhe detyrime te tjera

Vlera e mbartur e furnitoreve dhe kredive te pagueshme perafron vleren e tyre te drejte.

Pasqyrat Financiare
Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2021
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

20.3 Instrumenta financiare sipas kategorisë

Vlerat kontabel te aktiveve dhe detyrimeve financiare te Kompanise sic paraqiten ne daten e pasqyres se pozicionit financiar per periudhat raportuese nen rishikim mund te kategorizohen si vijon:

	Instrumente borxhi me kosot te amortizueshme	Aktive me vlere te drejte nepermjet fitim humbjes	Instrumente borxhi/ Aktive me vlere te drejte OCI	Totali
31 Dhjetor 2021				
Aktivët sipas pasqyres se pozicionit financiar				
Llogari te arketueshme dhe te tjera	-	-	-	-
Aktivët monetare dhe ekuivalentet e tyre	5,386,668	-	-	5,386,668
	5,386,668	-	-	5,386,668

	Detyrimet financiare me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes	Detyrimet financiare me kosto te amortizueshme	Totali
Detyrimet sipas pasqyres se pozicionit financiar			
Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera	-	949,219	949,219
	-	949,219	949,219

	Instrumente borxhi me kosot te amortizueshme	Aktive me vlere te drejte nepermjet fitim humbjes	Instrumente borxhi/ Aktive me vlere te drejte OCI	Totali
31 Dhjetor 2020				
Aktivët sipas pasqyres se pozicionit financiar				
Llogari te arketueshme dhe te tjera	-	-	-	-
Aktivët monetare dhe ekuivalentet e tyre	9,009,127	-	-	9,009,127
	9,009,127	-	-	9,009,127

	Detyrimet financiare me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes	Detyrimet financiare me kosto te amortizueshme	Totali
Detyrimet sipas pasqyres se pozicionit financiar			
Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera	-	886,633	886,633
	-	886,633	886,633

21 Tranaksione me palë të lidhura

	Të drejta	Detyrime	Të ardhura	Kosto
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2021				
Coral Societe Anonyme (Detyrim për pagesën e faturave të SBI për Q1 & Q2 2019)	-	554,118	-	-
Totali	-	554,118	-	-

	Të drejta	Detyrime	Të ardhura	Kosto
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020				
Coral Societe Anonyme (Detyrim për pagesën e faturave të SBI për Q1 & Q2 2019)	-	554,118	-	-
Totali	-	554,118	-	-

Pasqyrat Financiare
Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2021
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

22 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Angazhime

Shoqëria nuk ka angazhime materiale të nënkontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat të mos jenë reflektuar në pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe të dhënat kontabël për vitet financiare që përfundojnë më 31 Dhjetor 2018, 31 Dhjetor 2019, 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2021 nuk janë audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore të Shoqërisë mund të mos konsiderohen të finalizuara. Detyrime tatimore shtesë që mund të lindin në rast të auditimit të autoriteteve tatimore nuk mund të percaktohen me saktësi.

Çështje ligjore

Më 31 Dhjetor 2021 nuk ka çështje gjyqësore të ngritura kundër shoqërisë ose nga shoqëria.

23 Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.



Deklarata e hartuesit të pasqyrave financiare

Për Ortakun dhe Drejtimin e

Coral Albania Sha (referuar më poshte si “shoqëria”).

Ne kemi hartuar pasqyrat financiare të shoqërisë në bazë të dokumenteve që ju na keni ofruar. Këto pasqyra financiare përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë më 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Para hartimit të pasqyrave financiare të shoqërisë, TPA Albania shpk kreu shërbimet e kontabilitetit të cilat përfshinin regjistrimin e veprimeve kontabël dhe përgatitjen e bilancit verifikues.

Ne kemi aplikuar ekspertizën tonë në kontabilitetit dhe raportim financiar për t’ju ndihmuar në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”). Ne kemi qenë në përputhje me kërkesat etike relevante, duke përfshirë edhe parimet e integritetit, objektivitetit, kompetencën profesionale dhe kujdesin e duhur.

Këto pasqyra financiare, saktësia dhe plotësia e dokumenteve dhe informacionit të përdorura për të përpiluar ato janë përgjegjësia juaj. Përgjegjësia jonë është të hartojmë pasqyrat financiare në përputhje me Ligjin 25/2018 date 10 Maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm nr. 9228, datë 29.4.2004.

Meqenëse shërbimi i hartimit të pasqyrave financiare nuk është një shërbim sigurie, ne nuk jemi të detyruar të verifikojmë plotësinë e dokumenteve që ju na keni ofruar për hartimin e këtyre pasqyrave financiare. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion auditimi ose një konkluzion nëse këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Pasqyrat financiare të kompanisë janë përgatitur në gjuhën Angleze dhe përkthyer në gjuhën Shqipe. Versioni në gjuhën Angleze do të jetë versioni relevant ligjor dhe do të ketë përparësi ligjore në rast të ndonjë mospërputhje midis tekstit në Aglisht dhe përkthimit në ndonjë gjuhë tjetër.

Tiranë,
10 Shkurt 2022


Ilir Binaj CPA, CGMA
EKR Lic. Nr.205 date 04.10.2010



TPA Albania shpk
Rr.Ibrahim Rugova, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania
www.tpa-group.com